



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.50-2/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli, kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për rishqyrtim Anr.50-4/2025, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimeve të PZAP-it Anr.50/2025, dhe Anr.51/2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë;28.01.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa Anr.50-4/2025 e datës;27.01.2025, e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin dhe anulimin e vendimeve të PZAP-it, A.nr.50/2025, të datës;19.01.2025, me të cilin i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej 4,000.00 euro, dhe vendimi Anr.51/2025, i datës;19.01.2025, me të cilin i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej, 5.500.00, euro për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë;09.02.2025.

A r s y e t i m

Paneli me Vendimin Anr.50/2025 të datës 19.01.2025, subjektit ankues i ka shqiptuar dënim më gjobë në lartësi prej 4,000.00 euro, dhe me Vendimin Anr.51/2025, subjektit ankues i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 5.500.00 euro, në emër të të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

PZAP-i, me datë;27.01.2025, përmes postës ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Anr.50/2025, dhe vendimit Anr.51/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendohet se mbi bazën e prezentimit të fakteve të reja kontratës origjinale të nënshkruar nga palët, e cila ndër të tjerash përmban edhe numrin e protokollit dhe datën e nënshkrimit të saj, duke përfshirë edhe vulën e N.Sh "Foto Kabashi", me qëllimin që vendimet e lartcekura të anulohen pas rishikimit të tyre.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se, kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimeve Anr.50/2025 dhe vendimin Anr.51/2025, e datës;27.01.2025, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesa Anr.50-4/2025, e datës;27.01.2025, për rishqyrtimin e vendimeve rrjedh se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e parashtruara në kërkesë, kjo për faktin se PZAP-i pas shqyrtimit të kërkesës erdhi në përfundim se nuk kemi të bëjmë me prezentimin e fakteve të reja respektivisht kontratës origjinale të bashkangjitur kërkesës, e cila përveç numrit të cilin pala e konsideron si numër të protokollit nuk përmban vulë të protokollimit, për të vërtetuar faktin se kemi të bëjmë me subjekt që ushtron veprimtari të caktuar, përkatësisht e njëjta ka marrëveshje, përkatësisht pëlqim nga Komuna e Skenderaj për marrjen në shfrytëzim e hapësirave publike, e rrjedhimisht edhe të drejtën për të dhënë në shfrytëzim hapësirat reklamuese për subjektet politike.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura vendimet e kontestuara me rishikim, rezultojnë të jetë i drejta, të ndërtuara mbi fakte, prova dhe të mbështetura në dispozitat ligjore në fuqi.

Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118 paragrafi 4, me të cilin përcaktohet se, *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Në rastin konkret subjekti politik Partia Demokratik e Kosovës, kërkesën për rishikim të vendimit nuk e ka mbështetur në asnjë provë apo fakt të ri, që do ta bind panelin që të njëjtën kërkesë ta aprovojë si të bazuar.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.50-2/2025, datë;28.01.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.